



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

SSH.04 STANDARDET E PROGRAMEVE TE STUDIMIT

SSH.04.01 STANDARDET ME PROBLEMATIKE TE PERGJITHSHEME TE PROGRAMEVE TE STUDIMIT

SSH.04.01.01 Standardi i pergjithshem i programeve te studimeve

UPT duhet te siguroje arsimim të bazuar në kërkim dhe njohuri shkencore e teknologjike bashkëkohore; te siguroje arsimim të vazhduar, kualifikime, specializime; te përgatise specialistë te larte dhe shkencëtarë të rinj, me nivelin optimal cilesor, sherbime me nivelit cilesor bashkëkohor nivel i cili duhet te permiresohet vazhdimisht.

Mesimdhenia ne UPT duhet te zhvillohet ne perputhje me rregullat (standartet) dhe parimet e hapsires europiane te arsimit te larte

UPT duhet te ofrojë programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Programet e studimeve duhet te hartohen nga UPT dhe te miratohen në senatin e tij akademik.

UPT duhet te shpalle publikisht programet e akredituara të studimeve që ofron, para fillimit të aplikimeve për pranime në to.

SSH.04.01.02 Standardi i formave te studimeve

Format e studimeve në UPT mund te jene:

- a) studime me kohë të plotë;
- b) studime me kohë të pjesshme;
- c) studime në distancë.

Aplikimi dhe zbatimi i çdo njëres nga format e mesiperme te studimit ne UPT, duhet te bëhet me miratim të MASH.

SSH.04.01.03 Standardi i cikleve dhe titujve te studimeve universitare

Programet e studimeve në UPT duhet te organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë.

UPT duhet te ofrojë programe të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë vetëm në ato fusha, ku ato përmbushin kriteret dhe standartet shtetërore, në përputhje me Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007.

Programet e studimeve të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë janë programe të studimeve universitare.

UPT mund te ofrojë edhe programe të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale.

SSH.04.01.04 Standardi i krediteve

Nje krediti i formimeve universitare duhet t’i korespondojne 25 ore mesimore pune te studentit.

Sasia mesatare e punes se kryer gjate nje viti te studimeve universitare nga nje student me kohe te plote duhet te jete 60 kredite apo 1500 ore mesimore pune te studentit, qe perfshijne pune ne auditor dhe ore pune te pavarur te tij.

Oret per pune te pavarur te studentit duhet te zene jo me pak se gjysmen e fondit te pergjithshem te 1500 oreve mesimore.

Ngarkesa javore ne auditor per leksione, seminare, ushtrime dhe laboratore duhet te jete ne intervalin e 20 – 25 oreve mesimore 60 minuteshe.

Ne shtojcen 1 te Udhezimit Nr. 15, te MASH, dt. 04.04.2008 “Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte”jepen udhezime mbi kreditet dhe oret mesimore respektive, kreditet per veprimtarite e ndryshme formuese ne nje program studimi apo brenda nje disipline, ndarja e oreve mesimore per nje kredit, etj.

Kreditet koresponduese per çdo veprimtari formuese duhet te fitohen nga studentet vetem per vleresim pozitiv ne verifikimin perfundimtar te dijeve te fituara prej tyre. Per verifikimin e dijeve mund te perdoren

forma te ndryshme qe duhet te kombinojne verifikimin e vazhdueshem me ate perfundimtar (provimin). Njohja e plote apo e pjeseshme e krediteve te marra nga nje student me qellim vazhdimin e studimeve ne nje program tjetër studimi te UPT, duhet te behet nga njesia qe pret studentin, me procedura dhe kriteret te percaktuara ne rregulloren mesimore te UPT.

UPT mund te njohet si kredite te formimit universitar ne nje program te caktuar studimi, sipas kriterëve te caktuara, njohuri dhe aftesi profesionale te çertifikuara sipas akteve ligjore ne fuqi, si dhe njohuri te veprimtarive formuese te nivelit pas shkolles se mesme dhe qe jane ne perputhje me objektivat specifike te programit perkates te studimit.

Numri maksimal i krediteve te njohura ne kete rast nuk duhet t'i kaloje 60 kredite per programet e studimit te ciklit te pare dhe 40 kredite per programet e studimit te ciklit te dyte.

Ne rregulloren mesimore te UPT duhet te parashikohen kontrole per verifikimin dhe vleresimin periodik te krediteve te fituara nga studentet qe kane nderprere perkohesisht studimet, kontrole keto per te garantuar mosvjeterimin e dijeve dhe azhormimin e tyre per kreditet e fituara nga studentet. Edhe studenteve qe i kane zgjatur studimet per me shume se tre vjet pertej kohes normale te fitimit te diplomes per nje program te caktuar studimi, para dhenies se tezes se diplomes duhet t'ju kontrollohen gjithashtu kreditet e fituara.

SSH.04.01.05 Standardi i veprimtarive te orientimit dhe te kujdestarise (tutoratit)

Strukturat mesimore te UPT duhet te zhvillojne si veprimtari institucionale:

- a) kujdestari (tutorat) per studentet;
- b) keshillim per nxenesit per perzgjedhjen e programeve te studimit;
- c) perpunim dhe shperndarje te informacionit mbi programet e studimit, mbi funksionimin e sherbimeve per studentet;
- d) orientim per perfshirjen ne tregun e punes, etj.

UPT duhet te parashikojë me rregullore te posaçme kujdestarine (tutoratin) per studentet, per çdo program studimi nen pergjegjesine e keshillave te fakulteteve. Ky sherbim duhet te synojë mbeshtetjen e studenteve per parandalimin e largimeve apo zgjatjes se kohes se studimeve pertej kohezgjatjes normale te tyre, duhet t'i orientoje dhe asistojë studentet gjate gjithë programit te tyre te studimit dhe t'i nxise per nje pjesemarrje aktive te tyre ne jeten universitare ne te gjitha fushat dhe format e saj.

UPT duhet te ndermarre nisma per t'ju bere te njohur nxenesve te viteve te fundit te shkolles se mesme, programet e studimit qe ofron, strukturat perberese te tij dhe sherbimet per studentet, per te ndihmuar ne kete menyre nxenesit ne zgjedhjen e ndergjegjshme dhe te motivuar te programit/programeve te studimit.

Fakultetet e veçante duhet te organizojne, gjithashtu, takime orientuese, te programuara dhe te publikuara, per dhenien e informacioneve te detajuara mbi objektivat formues te programeve te ndryshme te studimit, te aktivizuara ne fakultetin e tyre, organizimin e tyre, mundesite per punesim, etj.

Personeli akademik, brenda kompetences se tij, duhet te impenjohet ne detyrat e organizuara dhe te nxitura nga sherbimet e percaktuar me siper.

Veprimtarite e kujdestarise duhet te zhvillohen ne bashkepunim me keshillat studentore respektive.

SSH.04.01.06 Standardi i zhvillimit te konkurseve te pranimit, i kuotave te pranimit, regjistrimeve te pranimit, i struktures se vitit akademik, transferimit te studimeve, i koeficienteve te lendeve me zgjedhje

Kerkesat per zhvillimin e konkurseve te pranimit, kuotat e pranimit, regjistrimet e pranimit, strukturen e vitit akademik, transferimin e studimeve, koeficientet e lendeve me zgjedhje jane objekt i perseritshem i VKM dhe udhezimeve te MASH dhe shpallen per çdo vit akademik ne veçanti.

SSH.04.01.07 Standardi i transferimeve

UPT duhet te ofrojë mundësi për transferime të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël, brenda UPT apo ne institucionet e ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë.

Vendimi për njohjen e plotë ose të pjeseshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim

vazhdimin e studimeve, duhet t'i takojë strukturës mësimore që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e UPT.

SSH.04.01.08 Standardi i lëshimit të diplomave, certifikatave dhe dokumenteve të tjera

UPT duhet të pajisë studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Individët, që kanë plotësuar detyrime ose pjesë të një programi studimi duhet të pajisen me certifikatat përkatëse, që perseri janë dokumente zyrtare.

Diplomat për ciklin e parë dhe për ciklin të dytë, si dhe diplomat “Master i Nivelit të Dytë” duhet të shoqërohen me suplementin e diplomës.

Suplementi i diplomës duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës duhet të përcaktohen nga senatet akademike, në përputhje me udhëzimet e MASH.

Çdo formë diplome ose certifikate, përpara se të lëshohet nga UPT, duhet të regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në MASH.

SSH.04.01.09 Standardi i njohjes dhe ekuivalentimit të diplomave dhe i periudhave të studimeve

Nëpërmjet ekuivalentimit, pjesë ose programe të plota studimi ose diploma të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja duhet të njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.

Ekuivalentimi duhet të bëhet nga UPT, pranë të cilit duhet paraqitur kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm.

Procedurat dhe kërkesat për ekuivalentim duhet të përcaktohen në statutin e UPT, në përputhje me Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007 dhe akte të tjera nënligjore.

Komisioni i ngritur nga fakulteti vlereson dhe merr vendimin përkatës për njohjen dhe ekuivalentimin e plote të diplomës, duke leshuar një certifikate njohje. Në rastet kur vendimi i komisionit të fakultetit është i ndryshëm nga ai i rekomanduar nga komisioni i MASH, komisioni i fakultetit konsultohet me MASH para marrjes së vendimit.

Kriteret, standardet dhe të gjitha detajet e procedurës së njohjes duhet të përcaktohen në rregulloren e UPT

SSH.04.01.10 Standardi i hapjes dhe mbylljes së programeve të studimeve të gjithë cikleve në UPT

Hapja dhe mbyllja e programeve të studimeve të të gjitha cikleve në UPT duhet të bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozimin e MASH, mbështetur në kërkesat e UPT.

MASH, para se të marrë vendimet e mesiperme, duhet të kërkojë vlerësimin e programeve të studimeve prej Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

SSH.04.02 STANDARDET E STUDIMEVE TE CIKLIT TË PARË

SSH.04.02.01 Standardi i udhezimeve te pergjithshme per programet e studimit te ciklit te pare

Programet e studimeve të ciklit të parë duhet të synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të gjerë profesioneve e specialitetesh.

Programet e studimeve të ciklit të parë duhet të realizohen me 180 kredite dhe zgjatja normale e tyre duhet të jete tre vite (çdo vit 60 kredite).

Per fitimin e diplomes se nivelit te pare (DNP) duhet te parashikohet pergatitja e nje teze diplome (po FIN???) , pa kerkesa per origjinalitet te veçante.

Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), në fushën e arsimimit të kryer.

Ne rastin e mbylljes se programeve te studimit te ciklit te pare, UPT duhet te parashikojte per studentet mundesine e perfundimit te studimeve ne nje program te njejte ose te ngjashem studimi.

SSH.04.02.02 Standardi i hapjes se programeve te studimit te ciklit te pare

Hapja e programeve te studimit te ciklit te pare duhet te behet kur UPT ploteson kriteret:

- a) strukturore;
- b) organizative;
- c) te personelit akademik, qe do te aktivizohet ne realizimin e disiplinave apo veprimtarive te tjera formuese.

SSH.04.02.03 Standardi i objektiveve te programeve te studimeve te ciklit te pare

Çdo program studimi i ciklit te pare duhet te kete objektiva te caktuara per formimin e studenteve ne ate program, te cilat perbehen nga bashkesia e dijeve, aftesimeve e kompetencave profesionale qe studentet duhet te fitojne ne perfundim te programit te studimit dhe qe karakterizojne profilin kulturor dhe profesional te programit.

Objektivat per formimin e studenteve ne nje program studimi, duhet te ndahen ne:

- a) Objektiva percaktues te programit te studimit, te cilat jane te njejta per programe studimi te njejta apo te ngjashme, te ofruara nga UPT. Keto percaktojne pergatitjen, njohurite, kompetencat dhe mundesite per punesim dhe jane te njejta, pavaresisht emertimit te programit.
- b) Objektiva specifike, te cilet diferencojne programet e njejta ose te ngjashme nga njeri tjetri. Keto objektiva duhet te percaktohen nga UPT.

Per çdo program te caktuar studimi, objektivat formues percaktues te programit dhe veprimtarite formuese (te dhena me poshte) te domosdoshme per t'u ndjekur, duhet te grupohen si me poshte:

- a) veprimtari formuese ne nje ose me shume grupe disiplinash qe lidhen me formimin e pergjithshem (baze) per programin e studimit;
- b) veprimtari formuese ne nje ose me shume grupe disiplinash qe karakterizojne perkatesine e programit te studimit.

SSH.04.02.04 Standardi i veprimtarive formuese te programeve te studimeve te ciklit te pare

Veprimtarite formuese qe karakterizojne nje program studimi duhet te ndahen ne:

- a) mesim ne auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore);
- b) studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, pergatitje provimesh, pergatitja e tezesh se diplomes, etj.);
- c) veprimtari te tjera, si praktika profesionale apo stazh prane subjekteve publike apo private.

Pervec veprimtarive formuese te mesiperme, programet e studimit duhet te parashikojne, gjithashtu:

- a) veprimtari formuese te zgjedhura nga vete studentet, ndermjet atyre te ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, te realizuar keto gjate viteve akademike te programit te studimit;
- b) veprimtari formuese ne nje ose me shume disiplinash te ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese, qe lidhen kryesisht me formime nderdisiplinore, njohuri ekonomike, juridike, etj.;
- c) veprimtari formuese te paparashikuara me siper dhe te fokusuara drejt perftimit te aftesive ne gjuhe te huaj, aftesive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese, ose pergjithsisht te aftesive qe lehtesojne hyrjen ne tregun e punes, sikurse aktivitetet formuese qe lidhen me praktiket profesionale prane kompanive te ndryshme, administrates publike, enteve private apo publike, urdherave apo kolegjeve profesionale, bazuar ne marreveshje te perbashketa per kete qellim.
- d) veprimtari formuese qe lidhen me pergatitjen e tezës se diplomes.

Ndarja e oreve mesimore ne auditor ne ore per leksione, seminare, ushtrime e laboratore per çdo disipline duhet te percaktohet nga personeli akademik pergjegjes per disiplinën, ne baze te krediteve qe asaj disipline i jane besuar.

UPT duhet te caktojë per çdo disipline/lende nje numer te pershtatshem kreditesh, duke evituar ndarjen ne pjese te vogla /copezimin, e veprimtarive formuese. **Per çdo program studimi te ciklit te pare nuk mund te parashikohen ne total me shume se 22 provime apo forma te tjera vleresimi perfundimtar te dijeve, te fituara ne nje disipline apo veprimtari tjeter formuese, duke realizuar provime te integruara per me shume se nje disipline apo module te koordinuara.** Ne keto raste lektorët (titullarët) e ketyre disiplinave duhet te bejne vleresim kolegjal te studentit, sipas modaliteteve te parashikuara ne rregulloren mesimore te UPT. Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 “Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte”, jepen rekomandime per shperndarjen e krediteve sipas veprimtarive te ndryshme formuese, si dhe ndarja e oreve mesimore per nje kredit ne ore ne auditor dhe ore per studim individual.

Studenteve, ne perfundim te programit te studimit, ju njehesohet nota mesatare e ponderuar, qe merr ne konsiderate edhe kreditet respektive per çdo disipline apo veprimtari tjeter formuese.

Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 “Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte”, jepet nje shembull i njehesimit te notes mesatare te ponderuar.

SSH.04.02.05 Standardi i elementeve të programeve të studimeve te ciklit te pare

Programet e studimeve të ciklit të parë duhet të përmbajnë elementet e mëposhtme:

- a) të dhëna të përgjithshme për programin, formën dhe objektivat kryesorë, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve;
- b) klasifikimin e programit të studimit, që bëhet i zbatueshëm me krijimin e kuadrit shtetëror të kualifikimeve;
- c) kushtet e pranimeve në programin e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes në rastet e pranimeve me numër të kufizuar;
- ç) metodat e vlerësimit të studentëve dhe kushtet për përparim në program;
- d) kushtet për transferime ndërmjet programeve dhe kushtet për përfundimin e pjesëshëm të programit, nëse ai e parashikon këtë gjë;
- dh) titujt profesionalë, që akordohen sipas ligjit, etj.

UPT duhet te percaktojë në statut dhe ne rregullore elemente më të hollësishme të programeve të ndryshme të studimeve.

SSH.04.02.06 Standardi i elementeve te planit mesimor te programeve te studimit te ciklit te pare

Ne planin mesimor te çdo programi studimi, duhet te percaktohen:

- a) emertimi dhe objektivat formuese te programit te studimit;
- b) kuadri i pergjithshem i veprimtarive formuese qe duhen te perfshihen ne kurrikula;
- c) kreditet per çdo veprimtari formuese.

Per percaktimet e mesiperme, UPT duhet te konsultohet paraprakisht me perfaqesues te bizneseve,

sherbimeve apo profesioneve respektive, duke j'u referuar gjithashtu edhe nevojave e kerkesave te tregut.

SSH.04.02.07 Standardi i pranimit te studenteve në programet mesimore te ciklit te parë

Çdo shtetas shqiptar, që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, qe zoteron nje diplome tjetër studimi te fituar jashte vendit, te vleresuar ekuivalente me te ose qe zoteron nje diplome te leshuar nga nje institucion i arsimit te larte, duhet te kete të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në UPT.

Kuotat e pranimit në UPT, për ciklin e parë të studimeve, duhet te miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të MASH. MASH duhet te formuloje propozimin e saj pas konsultimit me UPT dhe rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

Kuotat dhe kriteret e pranimit për ciklin e parë të studimeve për studentët e huaj në UPT bëhen perseri si me siper. Në përcaktimin e kuotave respektohen marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.

UPT mund te përcaktojë kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kriteret bëhen publikisht të njohura nga UPT të paktën një vit para fillimit të pranimeve të radhës në institucion, së bashku me informacionin e nevojshëm mbi UPT dhe programet që ofron. Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e pranimit në ciklin e parë të studimeve duhet te përcaktohen me udhëzim të MASH.

SSH.04.02.08 Standardi i grupeve mesimore ne programet e studimit te ciklit te pare

Grupet mesimore te programeve te ciklit te pare ne UPT mund te organizohen me 100 studente.

Ndersa per zhvillimin e veprimtarive praktike te procesit mesimor, grupet e studenteve ne UPT mund te ndahen ne kete menyre: grupi mesimor per praktikat mesimore apo profesionale te kete (25 – 40) studente; grupi mesimor per laboratore (10 -15) studente.

Normativat e percaktuara me siper mund te mos respektohen vetem ne rastet kur numri i studenteve te regjistruar ne nje program studimi eshte me i vogel se ai i percaktuar ne normativat e mesiperme ose ne raste te tjera me vendim te Keshillit te Administrimit.

SSH.04.02.09 Standardi i permbajtjes dhe formes se diplomes te programeve te studimit te ciklit te pare

Diploma e programeve te studimit duhet te jete shkruar ne gjuhen shqipe. Diploma e ciklit te pare te studimeve ne UPT duhet te jete ne ngjyre te kalter te lehte.

Diploma e secilit student duhet te permbaje keto te dhena:

- a) Stemen e Republikes se Shqiperise dhe emblemen e UPT;
- b) emertimin “Republika e Shqiperise”;
- c) emertimin “Universiteti Politeknik i Tiranes”;
- d) emrin, atesine dhe mbiemrin e studentit;
- e) vendin, daten, muajin dhe vitin e lindjes;
- f) emertimin e diplomes ne fushen e arsimimit te kryer;
- g) vitin e fillimit dhe te perfundimit te studimeve;
- h) numrin e amzes se studentit (matrikullimit) dhe numrin e regjistrit te diplomes;
- i) daten, muajin dhe vitin e akordimit te diplomes;
- j) emrin e rektorit te UPT dhe dekanit te fakultetit perkates te shkruar me dore.

Diplomat duhet te shtypen ne format jo me te vogel se A4 me leter jo me te vogel se 200 gr/m². Ne shtypjen e diplomave duhet te parashikohen dhe elemente te sigurise ne leter dhe ne formulimin grafik te tyre.

Modeli i diplomes, i pergatitur si me siper, duhet te miratohet ne MASH.

Diploma duhet te leshohet nga UPT deri ne 6 muaj pas perfundimit te studimeve. Deri ne paisjen me diplome te diplomanteve, UPT eshte i detyruar t'ju leshoje atyre nje vertetim per diplomen e fituar, te shoqeruar me fleten e notave.

SSH.04.02.10 Standardi i permbajtjes se “Shtojces se Diplomes” (Suplimentit te Diplomes) ne programet e

studimit te ciklit te pare

UPT duhet te paise te gjithe studentet ne perfundim te ciklit te pare te studimeve se bashku me Diplomen e Nivelit te Pare (DNP) edhe me “Shtojcen se Diplomes” (Suplimentin e Diplomes), qe duhet te jete i shkruar ne gjuhen shqipe dhe angleze.

Suplementi i diplomes duhet te permbaje te dhenat e meposhtme:

- a) informacion identifikimi per mbajtjen e kualifikimeve (emer, mbiemer; data, vendi dhe rajoni i lindjes; numri rendor i studenteve ose kodi);
- b) informacion identifikimi i kualifikimit (emertimi i kualifikimit (i plote, i shkurtuar); emertimi i titullit (i plote, i shkurtuar); fushat kryesore te studimeve te nevojshme per kualifikim; emri i institucionit te vleresimit te kualifikimit, statusi, tipi, kontrolli; gjuhet e instruksionit/shqyrtimit);
- c) informacion per nivelin e kualifikimit (niveli i kualifikimit, koha zyrtare e programit; kerkesat hyrese);
- d) informacion per brendine, permbajtjen dhe rezultatet e fituara (menyra e studimit; programi i detajuar, skema e diplomimit, niveli i udheheqies; klasifikimi i pergjithshem);
- e) informacion per funksionin e kualifikimeve (hyrje ne studimin e metejshe; statusi profesional);
- f) informacion shtese (burimet e informacionit shtese);
- g) certifikimi i “Shtojces se Diplomes”(Suplementit te Diplomes) (kjo diplome shtese i referohet origjines se meposhtme: dokumentet);
- h) informacion per sistemin kombetar te arsimit (stamp/vule).

SSH.04.03 STANDARDET E STUDIMEVE TE CIKLIT TË DYTË

SSH.04.03.01 Standardi i udhezimeve te pergjithshme per programet e studimit te ciklit te dyte

Programet e studimeve të ciklit të dytë perbejne nivelin e dyte te formimit universitar dhe duhet te japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda një specialiteti.

Programet e studimeve të ciklit të dytë duhet te realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre duhet te jete dy vite (çdo vit 60 kredite).

Per fitimin e diplomave te nivelit te dyte (DND), duhet te parashikohet pergatitja e nje teze diplome, te perpunuar ne menyre te pavarur dhe krijuese nga studenti.

Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dyte lëshohet diplomë e nivelit të dyte (DND) në fushën e arsimimit të kryer.

Ne rastin e mbylljes se programeve te studimit te ciklit te dyte, UPT duhet te parashikojte per studentet mundesine e perfundimit te studimeve ne nje program te njejte ose te ngjashem studimi.

SSH.04.03.02 Standardi i objektivave te programeve te studimeve te ciklit te dyte

Çdo program studimi i ciklit te dyte duhet te kete objektiva te caktuara per formimin e studenteve ne ate program, te cilat perbehen nga bashkesia e dijeve, aftesimeve e kompetencave profesionale qe studentet duhet te fitojne ne perfundim te programit te studimit dhe qe karakterizojne profilin kulturor dhe profesional te programit.

Objektivat per formimin e studenteve ne nje program studimi, duhet te ndahen ne:

- c) Objektiva percaktues te programit te studimit, te cilat jane te njehta per programe studimi te njehta apo te ngjashme, te ofruara nga UPT. Keto percaktojne pergatitjen, njohurite, kompetencat dhe mundesite per punesim dhe jane te njehta, pavaresisht emertimit te programit.
- d) Objektiva specifike, te cilet diferencojne programet e njehta ose te ngjashme nga njeri tjetri. Keto objektiva duhet te percaktohen nga UPT.

Per çdo program te caktuar studimi, objektivat formues percaktues te programit dhe veprimtarite formuese (te dhena me poshte) te domosdoshme per t'u ndjekur, duhet te grupohen si me poshte:

- c) veprimtari formuese ne nje ose me shume grupe disiplinash qe lidhen me formimin e pergjithshem (baze) per programin e studimit;
- d) veprimtari formuese ne nje ose me shume grupe disiplinash qe karakterizojne perkatesine e programit te studimit.

SSH.04.03.03 Standardi i veprimtarive formuese te programeve te studimeve te ciklit te dyte

Veprimtarite formuese qe karakterizojne nje program studimi duhet te ndahen ne:

- a) mesim ne auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore);
- b) studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, pergatitje provimesh, pergatitja e tezesh se diplomes, etj.);
- c) veprimtari te tjera, si praktika profesionale apo stazh prane subjekteve publike apo private.

Pervec veprimtarive formuese te mesiperme, programet e studimit duhet te parashikojne, gjithashtu:

- a) veprimtari formuese te zgjedhura nga vete studentet, ndermjet atyre te ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, te realizuar keto gjate viteve akademike te programit te studimit;
- b) veprimtari formuese ne nje ose me shume disiplinash te ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese, qe lidhen kryesisht me formime nderdisiplinore, njohuri ekonomike, juridike, etj.;
- c) veprimtari formuese te paparashikuara me siper dhe te fokusuar drejt perftimit te aftesive ne gjuhe te huaj, aftesive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese, ose pergjithsisht te aftesive qe lehtesojne hyrjen ne tregun e punes, sikurse aktivitete formuese qe lidhen me praktikat

profesionale prane kompanive te ndryshme, administrates publike, enteve private apo publike, urdherave apo kolegjeve profesionale, bazuar ne marreveshje te perbashketa per kete qellim.

d) veprimtari formuese qe lidhen me pergatitjen e tezes se diplomes.

Ndarja e oreve mesimore ne auditor ne ore per leksione, seminare, ushtrime e laboratore per çdo disipline duhet te percaktohet nga personeli akademik pergjegjes per disiplinen, ne baze te krediteve qe asaj disipline i jane besuar.

UPT duhet te caktojte per çdo disipline/lende nje numer te pershtatshem kreditesh, duke evituar ndarjen ne pjese te vogla /copezimin, e veprimtarive formuese. **Per çdo program studimi te ciklit te dyte nuk mund te parashikohen ne total me shume se 14 provime apo forma te tjera vleresimi perfundimtar te dijeve, te fituara ne nje disipline apo veprimtari tjeter formuese, duke realizuar provime te integruara per me shume se nje disipline apo module te koordinuara.** Ne keto raste lektoret (titullaret) e ketyre disiplinave duhet te bejne vleresim kolegjal te studentit, sipas modaliteteve te parashikuara ne rreguloren mesimore te UPT.

Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 "Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte", jepen rekomandime per shperndarjen e krediteve sipas veprimtarive te ndryshme formuese, si dhe ndarja e oreve mesimore per nje kredit ne ore ne auditor dhe ore per studim individual.

Studenteve, ne perfundim te programit te studimit, ju njehesohet nota mesatare e ponderuar, qe merr ne konsiderate edhe kreditet respektive per çdo disipline apo veprimtari tjeter formuese.

Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 "Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte", jepet nje shembull i njehesimit te notes mesatare te ponderuar.

SSH.04.03.04 Standardi i kerkesave mbi permbajtjen e programeve te studimeve te ciklit te dyte

Programet e studimit te ciklit te dyte, nepermjet aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, duhet te garantojne:

- a) specializim te njohurive te studenteve, krahasuar me programet e studimit te ciklit te pare; pergatitje te avancuar te tyre per formimin e kompetencave dhe aftesive, qe t'ju korespondojne niveleve te kualifikuara te punesimit dhe profesionalizmit;
- b) trajnim per kerkim te pavarur nepermjet njohjes se metodave, instrumenteve dhe teknikave te kerkimit.

Programet e studimit te ciklit te dyte duhet te hartohen ne menyre te tille qe:

- a) te shmangin perseritjen e njohurive formuese te programit te studimit te ciklit te pare, duke ofruar disiplina te nje karakteri me te avancuar e specializues;
- b) kurikulat e tyre duhet t'i korespondojne nje formimi baze te gjere dhe fleksibel, duke ju dhene peshe programeve nderdisiplinore, me qellim mundesimin e pranimi ne keto programe studimi si te studenteve te diplomuar ne programin respektiv te tudimit te ciklit te pare, ashtu dhe te atyre te diplomuar ne programe te aferta studimi te ciklit te pare;
- c) te reflektojne bashkepunimin me tregun e punes dhe profesioneve ne nivel kombetar dhe lokal.

Ne perfundim te programit te studimit te ciklit te dyte duhet te parashikohet realizimi i nje teze diplome, si pjese perberese e tij, dhe te lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND) në fushën e arsimit të kryer.

SSH.04.03.05 Standardi i lidhjeve/raporteve te programit te studimit te ciklit te dyte me programet e studimit te ciklit te pare, qe mundesojne pranimin e studenteve ne ta

UPT duhet te percaktojte listen e programeve te studimit te ciklit te pare, qe mundesojne pranimin ne nje program studimi te ciklit te dyte, si me poshte:

- a) programin apo programet e studimit te ciklit te pare qe lejojne regjistrimin ne programin e studimit te ciklit te dyte pa plotesime shtese (pa debite formimi);
- b) programin apo programet e studimit te ciklit te pare qe lejojne regjistrimin ne programin e studimit te ciklit te dyte me plotesim te njohurive formuese (me debite formimi), si per shembull, programe studimi i aferta te UPT apo programe te njejta e te aferta te institucioneve te tjera te arsimit te larte.

Ne çdo program studimi te ciklit te dyte,se paku, nje program studimi i ciklit te pare duhet te kaloje pa debite formimi.

Ne programet e studimit e ciklit te pare me plotesim te njohurive formuese (me debite formimi) perfshihen programet, njohurite plotesuese te cilave konsiderohen te perputhshme dhe te pranueshme per regjistrimin ne program por jo me pak se 2/3 e numrit te pergjithshem te krediteve te tyre, (jo me pak se 120 kredite). Vleresimi i programeve te studimit te ciklit te pare duhet te kryhet nga nje grup profesorësh te njesise kryesore ku do te zhvillohet programi i studimit i ciklit te dyte (strukture pergjegjese), te caktuar nga dekani.

Kur nje programi studimi te ciklit te pare i vleresohen te pranueshme jo me pak se 120 kredite, struktura akademike pergjegjese percakton disiplinat ne te cilat studenti duhet te beje plotesimet e krediteve te mangeta (debitet e formimit). Ne çdo rast, numri maksimal i krediteve te mangeta per t'u plotesuar nuk duhet te kaloje 60 kreditet.

Mund te njihen si kredite te realizuara per nje program studimi te ciklit te dyte, kredite te fituara ne programet Master i Nivelit te Pare ,por jo me shume se 12-15 kredite.

Nuk duhet te njihen si kredite te realizuara per nje program studimi te ciklit te dyte, kredite te fituara ne çfaredo program studimi te ciklit te pare.

Njesite kryesore pergjegjese per nje program studimi te ciklit te dyte duhet te japin informacionet e nevojshme per plotesimin e njohurive formuese (debitet e formimit). Ato duhet te percaktojne edhe procedurat per kryerjen e ketyre plotesimeve para pranimit ne programin e studimit te ciklit te dyte, duke organizuar per kete qellim dhe sherbimet e nevojshme te tutoratit (kujdestarise) per studentet.

SSH.04.03.06 Standardi i kushteve per hapjen/organizimin e programeve te studimit te ciklit te dyte

Per hapjen/organizimin e programeve te studimit te ciklit te dyte, njesite duhet te plotesojne kushtet e meposhtme:

- a) personel akademik me kualifikimin ,kompetencat kurrikulare dhe ne numrin e nevojshme, per zhvillimin e disiplinave te ndryshme te programit te studimit;
- b) infrastrukturen e nevojshme dhe te pershtatshme mesimore, laboratorike, kompjuterike, publikime, etj. Per aktivitetet e parashikuara ne programin e studimit;
- c) mundesi per realizimin e temes se diplomes.

Programet e studimit te ciklit te dyte duhet te funksionojne ne perputhje me rregulloret perkatese te tyre.

SSH.04.03.07 Standardi i dokumentacionit te hapjes/organizimit te programeve te ciklit te dyte

UPT kerkesen per hapjen/organizimin e programeve te studimit te ciklit te dyte duhet t'a shoqerojne me dokumentacionin e meposhtem:

- a) objektivat formues te programit, kompetencat profesionale qe synohet te arrihen ne perfundim te tij dhe ndihmesen per qellim punesimi;
- b) planin mesimor te programit, te detajuar ne aktivitetet e ndryshme formuese, shoqeruar me kreditet dhe oret mesimore perkatese;
- c) personelin akademik qe do te angazhohet per realizimin e programit te studimit, shoqeruar dhe me te dhenat e nevojshme te kualifikimit te tij dhe te fushave mesimore dhe kerkimore te mbuluara prej tij;
- d) kriteret e pranimit te studenteve;
- e) programet e studimit te ciklit te pare, qe mundesojne pranimin ne programin e studimit, pa ose me plotesim te njohurive formuese para hyrjes ne program;
- f) mundesite e transferimit te studenteve ndermjet programeve te studimit te ciklit te dyte;
- g) modalitetet e pergatitjes, paraqitjes dhe vleresimit te tezës se diplomes;
- h) numrin minimal dhe maksimal te pjesemarrësve ne program;
- i) frekuencen ne aktivitetet e ndryshme formuese (leksione, seminare, laboratore, praktika, etj.);
- j) strukturen akademike pergjegjese;
- k) propozimin per tarifen e shkollimit, te argumentuar lidhur me koston;
- l) rregulloren e programit te studimit;

m) modelin e diplomes dhe te suplementit te diplomes.

Formati per paraqitjen e dokumentacionit per elementet kryesore te cituar me siper, duhet te pergatitet sipas modelit ne shtojcen 1, bashkangjitur Udhezimit Nr. 14, dt. 3.04.2008 "Per hapjen dhe organizimin e programeve te studimit te ciklit te dyte ne institucionet publike te arsimit te larte". Dokumentacioni tjetër i kerkuar duhet te bashkelidhet si pjese perberese e propozimit.

Propozimet per hapjen/organizimin e programeve te studimit te ciklit te dyte mund te behen nga nje apo me shume njesi kryesore apo njesi baze.

Keto propozime shqyrtohen dhe miratohen ne keshillin e njesise kryesore perkatese dhe ne senatin akademik te UPT.

Kerkesat e UPT per hapjen/organizimin e programeve te studimit te ciklit te dyte duhet te paraqiten ne MASH brenda dates 31 mars te çdo viti.

SSH.04.03.08 Standardi i elementeve të programeve të studimeve te ciklit te dyte

Programet e studimeve të ciklit të dyte duhet të përmbajnë elementet e mëposhtme:

- a) të dhëna të përgjithshme për programin, formën dhe objektivat kryesorë, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve;
- b) klasifikimin e programit të studimit, që bëhet i zbatueshëm me krijimin e kuadrit shtetëror të kualifikimeve;
- c) kushtet e pranimeve në programin e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes në rastet e pranimeve me numër të kufizuar;
- ç) metodat e vlerësimit të studentëve dhe kushtet për përparim në program;
- d) kushtet për transferime ndërmjet programeve dhe kushtet për përfundimin e pjesëshëm të programit, nëse ai e parashikon këtë gjë;
- dh) titujt profesionalë, që akordohen sipas ligjit, etj.

UPT duhet te përcaktojë në statut dhe ne rregullore elemente më të hollësishme të programeve të ndryshme të studimeve.

SSH.04.03.09 Standardi i elementeve te planit mesimor te programeve te studimit te ciklit te dyte

Ne planin mesimor te çdo programi studimi, duhet te percaktohen:

- a) emertimi dhe objektivat formuese te programit te studimit;
- b) kuadri i pergjithshem i veprimtarive formuese qe duhen te perfshihen ne kurrikula;
- c) kreditet per çdo veprimtari formuese.

Per percaktimet e mesiperme, UPT duhet te konsultohet paraprakisht me perfaqesues te bizneseve, sherbimeve apo profesioneve respektive, duke j'u referuar gjithashtu edhe nevojave e kerkesave te tregut.

SSH.04.03.10 Standardi i pranimit te studenteve ne programet e studimit te ciklit te dyte

Per t'u pranuar ne nje program studimi te ciklit te dyte kandidati duhet te zoteroje diplome te nivelit te pare ose diplome tjetër studimi te fituar jashte vendit, te vleresuar ekuivalente me te.

UPT, pervec titullit apo titujve te diplomave te nivelit te pare qe duhet te zoterohen se paku nga studentet, si kusht per pranimin e tyre ne nje program studimi te caktuar te ciklit te dyte, qe lidhet me drejtimin e formimit te studenteve ne ciklin e pare dhe kualitetin e pergatitjes individuale te tyre, bazuar dhe ne rekomandimet e Keshillit te Arsimit te Larte dhe Shkences, mund te percaktoje, ne rregulloret mesimore perkatese, edhe kriteret e tjere specifike. Kriteret e pranimit te studenteve duhet te behen publike para fillimit te pranimeve te radhes ne UPT.

Kuotat e pranimit në UPT, për programet e studimeve të ciklit të dytë, duhet te miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të MASH. MASH duhet te formuloje propozimin e saj pas konsultimit me UPT, duke marre parasysh dhe rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

SSH.04.03.11 Standardi i grupeve mesimore ne programet e studimit te ciklit te dyte

Grupet mesimore te programeve te ciklit te pare ne UPT mund te organizohen me 80 studente. Ndersa per zhvillimin e veprimtarive praktike te procesit mesimor, grupet e studenteve ne UPT mund te ndahen ne kete menyre: grupi mesimor per praktikat mesimore apo profesionale te kete (25 – 40) studente; grupi mesimor per laboratore (10 -15) studente. Normativat e percaktuara me siper mund te mos respektohen vetem ne rastet kur numri i studenteve te regjistruar ne nje program studimi eshte me i vogel se ai i percaktuar ne normativat e mesiperme ose ne raste te tjera me vendim te Keshillit te Administrimit.

SSH.04.03.12 Standardi i permbajtjes dhe formes se diplomes te programeve te studimit te ciklit te dyte

Diploma e programeve te studimit duhet te jete shkruar ne gjuhen shqipe. Diploma e ciklit te dyte te studimeve duhet te jete ne ngjyre oker.

Diploma e secilit student duhet te permbaje keto te dhena:

- a) Stemen e Republikes se Shqiperise dhe emblemen e UPT;
- b) emertimin “Republika e Shqiperise”;
- c) emertimin “Universiteti Politeknik i Tiranes”;
- d) emrin, atesine dhe mbiemrin e studentit;
- e) vendin, daten, muajin dhe vitin e lindjes;
- f) emertimin e diplomes ne fushen e arsimimit te kryer;
- g) vitin e fillimit dhe te perfundimit te studimeve;
- h) numrin e amzes se studentit (matrikullimit) dhe numrin e regjistrimit te diplomes;
- i) daten, muajin dhe vitin e akordimit te diplomes;
- j) emrin e rektorit te UPT dhe dekanit te fakultetit perkates te shkruar me dore.

Diplomat duhet te shtypen ne format jo me te vogel se A4 me leter jo me te vogel se 200 gr/m². Ne shtypjen e diplomave duhet te parashikohen dhe elemente te sigurise ne leter dhe ne formulimin grafik te tyre.

Modeli i diplomes, i pergatitur si me siper, duhet te miratohet ne MASH.

Diploma duhet te leshohet nga UPT deri ne 6 muaj pas perfundimit te studimeve. Deri ne paisjen me diplome te diplomanteve, UPT duhet t’ju leshoje atyre nje vertetim per diplomen e fituar, te shoqeruar me fleten e notave.

SSH.04.03.13 Standardi i hapjes dhe mbylljes se programeve te studimit te ciklit te dyte

Hapja dhe mbyllja e programeve te studimit te ciklit te dyte ne UPT duhet te behet sipas percaktimeve te dhena ne Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007 dhe ne Udhezimin Nr. 14, dt. 3.04.2008 “Per hapjen dhe organizimin e programeve te studimit te ciklit te dyte ne institucionet publike te arsimit te larte”.

Ne rastin e mbylljes se programeve te studimit te ciklit te dyte, UPT duhet te parashikojte per studentet mundesine e perfundimit te studimeve ne nje program te njejte ose te ngjashem studimi.

SSH.04.04 STANDARDET E PROGRAMEVE TE STUDIMEVE “MASTER TE NIVELIT TE PARE” (MNP)

SSH.04.04.01 Standardi i udhezimeve te pergjithshme mbi programet e studimeve “Master i Nivelit të Parë”

Programet e studimeve MNP, si program studimi i ciklit te dyte, si rregull, duhet t’u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë të nivelit të parë, arsimim dhe trajnim të mëtëjshëm profesional.

Programet e studimit MNP duhet te disiplinohen me rregulloret perkatese te programit.

Në përfundim të këtyre programeve të studimeve duhet te jepet diploma “Master i Nivelit të Parë” në fushën e arsimimit dhe trajnimit të kryer.

SSH.04.04.02 Standardi i komitetit shkencor te programit te studimit “Master i Nivelit të Parë”

Pergjegjesia organizative per programin MNP duhet te jete e nje komiteti shkencor per çdo program, te perbere nga jo me pak se tre anetare te personelit akademik. Ky komitet duhet te caktohet nga njesia baze ose dhe mund te veteiniciohet. Ai duhet te percaktoje personelin tjeter akademik dhe ndihmes, me te cilin do te bashkepunoje per realizimin e programit te studimit.

Komiteti Shkencor duhet te zgjedhe nga perberja e tij koordinatorin e programit.

SSH.04.04.03 Standardi i regjistrimit (pranimit) te studenteve ne programin e studimit “Master i Nivelit të Parë”

Ne programet e studimit MNP duhet te pranohen vetem ata persona te cilet plotesojne standardet e kriteretve akademike te percaktuara nga institucioni, bazuar ne Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007 dhe aktet e tjera nenligjore ne fuqi. Standardet e kriteretve perzgjedhese duhet te behen publike para fillimit te pranimeve te radhes ne UPT.

Ne programet e studimit MNP duhet te regjistrohesh vetem personat qe zoterojne diplome te nivelit te pare, diplome te nivelit te dyte, diplome te integruar te nivelit te dyte apo diplome sipas sistemit te vjeter, te pandare ne cikle studimi.

SSH.04.04.04 Standardi i objektiveve te programeve te studimeve “Master i Nivelit të Parë”

Çdo program studimi i ciklit te pare duhet te kete objektiva te caktuara per formimin e studenteve ne ate program, te cilat perbehen nga bashkesia e dijeve, aftesimeve e kompetencave profesionale qe studentet duhet te fitojne ne perfundim te programit te studimit dhe qe karakterizojne profilin kulturor dhe profesional te programit.

Objektivat per formimin e studenteve ne nje program studimi, duhet te ndahen ne:

- a) Objektiva percaktues te programit te studimit, te cilat jane te njejta per programe studimi te njejta apo te ngjashme, te ofruara nga UPT. Keto duhet te percaktojne perгатitjen, njohurite, kompetencat dhe mundesite per punesim dhe jane te njejta, pavaresisht emertimit te programit.
- b) Objektiva specifike, te cilet duhet te diferencojne programet e njejta ose te ngjashme nga njeri tjetri. Keto objektiva duhet te percaktohen nga UPT.

Per çdo program te caktuar studimi, objektivat formues percaktues te programit dhe veprimtarite formuese (te dhena me poshte) te domosdoshme per t’u ndjekur, duhet te grupohen si me poshte:

- a) veprimtari formuese ne nje ose me shume grupe disiplinash qe lidhen me formimin e pergjithshem (baze) per programin e studimit;
- b) veprimtari formuese ne nje ose me shume grupe disiplinash qe karakterizojne perkatesine e programit te studimit.

SSH.04.04.05 Standardi i veprimtarive formuese te programeve te studimeve “Master i Nivelit të Parë”

Veprimtarite formuese qe karakterizojne nje program studimi duhet te ndahen ne:

- a) mesim ne auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore);
- b) studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, pergatitje provimesh, pergatitja e tezesh se diplomes, etj.);
- c) veprimtari te tjera, si praktika profesionale apo stazh prane subjekteve publike apo private.

Pervec veprimtarive formuese te mesiperme, programet e studimit duhet te parashikojne, gjithashtu:

- a) veprimtari formuese te zgjedhura nga vete studentet, ndermjet atyre te ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, te realizuar keto gjate viteve akademike te programit te studimit;
- b) veprimtari formuese ne nje ose me shume disiplinash te ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese, qe lidhen kryesisht me formime nderdisiplinore, njohuri ekonomike, juridike, etj.;
- c) veprimtari formuese te paparashikuara me siper dhe te fokusuara drejt perftimit te aftesive ne gjuhe te huaj, aftesive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese, ose pergjithsisht te aftesive qe lehtesojne hyrjen ne tregun e punes, sikurse aktivitete formuese qe lidhen me praktikat profesionale prane kompanive te ndryshme, administrates publike, enteve private apo publike, urdherave apo kolegeve profesionale, bazuar ne marreveshje te perbashketa per kete qellim.
- d) veprimtari formuese qe lidhen me pergatitjen e tezesh se diplomes.

Ndarja e oreve mesimore ne auditor ne ore per leksione, seminare, ushtrime e laboratore per çdo disipline percaktohet nga personeli akademik pergjegjes per disiplinen, ne baze te krediteve qe asaj disipline i jane besuar.

Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 "Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte", jepen rekomandime per shperndarjen e krediteve sipas veprimtarive te ndryshme formuese, si dhe ndarja e oreve mesimore per nje kredit ne ore ne auditor dhe ore per studim individual.

Studenteve, ne perfundim te programit te studimit, ju njehesohet nota mesatare e ponderuar, qe merr ne konsiderate edhe kreditet respektive per çdo disipline apo veprimtari tjetër formuese.

Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 "Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte", jepet nje shembull i njehesimit te notes mesatare te ponderuar.

SSH.04.04.06 Standardi i organizimit, kryerjes dhe vleresimit te programit te studimit "Master i Nivelit të

Parë"

Programet e studimit MNP duhet te realizohen nepermjet aktiviteteve te ndryshme formuese ne auditor, trainimit, praktikes apo stazhit, ne perputhje me objektivat e programit si dhe studimit e pergatitjes individuale te studenteve. Numri minimal i krediteve per keto programe studimi nuk mund te jete me i vogel se 60 kredite apo 1500 ore pune te studentit, te shperndara ne jo me pak se nje vit akademik.

Programet e studimit MNP mund te zhvillohen dhe me kohe te pjeseshme dhe ne kete rast ato duhet te shtrihen ne dy vite akademike.

Frekuentimi nga studentete i aktiviteteve te ndryshme formues duhet te jete i detyrueshem. Ne çdo rast, per marrjen e titullit te studimit, frekuentimi duhet te jete te pakten ne masen 80% te aktiviteteve mesimore ne auditor.

Ne perfundim te programeve te studimit MNP duhet te parashikohet realizimi i nje prove finale (mikroteze, testim) qe te vertetoje fitimin e kompetencave profesionale apo njohurive te parashikuara.

Organizimi dhe drejtimi i programeve te studimit MNP, si dhe aktiviteti mesimor i zhvilluar nga personeli akademik ne keto programe, duhet te vleresohen me ore mesimore.

Asnje nga programet e studimit MNP nuk mund te ekuivalentohen me ndonje diplome te nivelit te dyte.

Rezultatet dhe niveli cilesor i aktiviteteve formuese te zhvilluara ne programet e studimit MNP vleresohen çdo vit ne perfundim te tij, sipas modaliteteve te percaktuara nga njesia e sigurimit te brendshem te cilesise. Ky vleresim sherben si baze per vazhdimesine e programit te studimit ne vitin e ardhshem.

SSH.04.04.07 Standardi i dokumentacionit per hapjen e programit te studimit “Master i Nivelit të Pare”

Propozimet per hapjen, mbylljen apo riorganizimin e programeve te studimit MNP mund te behen nga nje apo me shume njesi kryesore, njesi baze apo dhe anetare te personelit akademik, kur disponohen burime te pershtatshme njerezore dhe te infrastruktures. Keto propozime duhet te shqyrtohen per plotesimin e standardeve akademike ne keshillin e njesise kryesore perkatese dhe ne senatin akademik te UPT.

UPT kerkesen per hapjen dhe riorganizimin e programeve te studimit MNP duhet t’a shoqeroje me dokumentacionin e meposhtem:

- a) objektivat e programit, kompetencat profesionale qe synohet te arrihen ne perfundim te tij dhe ndihmesen per qellim punesimi;
- b) kriteret e pranimit te studenteve;
- c) procedurat e pranimit te studenteve dhe te njohjes se krediteve universitare te fituara me pare prej tyre;
- d) kohezgjatja e programit dhe struktura qe e ofron;
- e) numri minimal dhe maksimal i pjesemarrësve ne program;
- f) frekuenca ne aktivitetet e ndryshme formuese (leksione, seminare, laboratore, praktika, etj.);
- g) plani mesimor i programit, i detajuar ne te gjitha aktivitetet formuese, shoqeruar me kreditet perkatese;
- h) personeli akademik qe duhet te angazhohet per realizimin e programit te studimit, shoqeruar me te dhenat e nevojshme;
- i) komiteti shkencor dhe koordinatori i programit;
- j) struktura akademike pergjegjese per menaxhimin administrativ dhe financiar te programit si dhe te karrieres se studenteve;
- k) tarifa per çdo student dhe menyra si dhe afatet e pageses se saj; programet e studimit MNP vetefinancohen me tarifat e shkollimit te studenteve te regjistruar ne keto programe; sidoqofte, ato mund te shfrytezojne dhe financime nga subjekte bashkepunuese per programin, si dhe burime te siguruara nga njesia/njesite kryesore propozuese apo nga UPT.
- l) rregullorja e programit te studimit;
- m) modeli i diplomes.

Kerkesa dhe dokumentacioni i nevojshem per hapjen apo riorganizimin e programeve te studimit MNP duhet te shoqerohet me nje permbledhje te paraqitur sipas modelit te dhene ne shtojcat e Udhezimit Nr.4, dt 22.01.2008 “Per hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve te studimit Master te Nivelit te Pare dhe te Dyte”.

SSH.04.04.08 Standardi i elementeve te planit mesimor te programeve te studimit “Master i Nivelit të Pare”

Ne planin mesimor te çdo programi studimi, duhet te percaktohen:

- a) emertimi dhe objektivat formuese te programit te studimit;
- b) kuadri i pergjithshem i veprimtarive formuese qe duhen te perfshihen ne kurrikula;
- c) kreditet per çdo veprimtari formuese.

Per percaktimet e mesiperme, UPT duhet te konsultohet paraprakisht me perfaqesues te bizneseve, sherbimeve apo profesioneve respektive, duke j’u referuar gjithashtu edhe nevojave e kerkesave te tregut. Kerkesat e UPT per hapjen dhe mbylljen e programeve te studimit MNP duhet te paraqiten ne MASH brenda dates 15 mars te çdo viti. Hapja dhe mbyllja e programeve te studimit MNP duhet te behet sipas percaktimeve te dhena ne standardin e pergjithshem te programeve te studimeve.

SSH.04.05 STANDARDET E PROGRAMEVE TE STUDIMEVE “MASTER TE NIVELIT TE DYTE” (MND)

SSH.04.05.01 Standardi i udhezimeve te pergjithshme mbi programet e studimeve “Master i Nivelit të Dyte”

Programet e studimeve MND, si programe studimi te ciklit te trete, duhet t’u ofrojnë të diplomuarve, si rregull me një diplomë të nivelit të dytë, arsimim dhe trajnim të një niveli më të lartë shkencor ose profesional.

Programet e studimit MND duhet te disiplinohen me rregulloret perkatese te programit.

Në përfundim të këtyre programeve të studimeve duhet te jepet diploma “Master i Nivelit të Dytë”.

Diplomat e fituara në studimet në kuadër të “Shkollës pasuniversitare të studimeve të thelluara” janë ekuivalente me diplomat MND.

SSH.04.05.02 Standardi i komitetit shkencor te programit te studimit “Master i Nivelit të Dyte”

Pergjegjësia organizative per programin MND duhet te jete e nje komiteti shkencor per çdo program, te perbere nga jo me pak se tre anetare te personelit akademik. Ky komitet duhet te caktohet nga njesia baze ose dhe mund te veteinicohet. Ai percakton personelin tjeter akademik dhe ndihmes, me te cilin do te bashkepunoje per realizimin e programit te studimit.

Komiteti Shkencor duhet te zgjedhe nga perberja e tij koordinatorin e programit.

SSH.04.05.03 Standardi i regjistrimit (pranimit) te studenteve ne programin e studimit “Master i Nivelit të Dyte”

Ne programet e studimit MND duhet te pranohen vetem ata persona te cilet plotesojne standardet e kriterave akademike te percaktuara nga institucioni, bazuar ne Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007 dhe aktet e tjera nenligjore ne fuqi. Standardet e kriterave perzgjedhese duhet te behen publike para fillimit te pranimeve te radhes ne institucion.

Ne programet e studimit MND duhet te regjistrohen vetem personat qe zoterojne diplome te nivelit te dyte, diplome te integruar te nivelit te dyte apo diplome sipas sistemit te vjeter, te pandare ne cikle studimi.

SSH.04.05.04 Standardi i objektiveve te programeve te studimeve “Master i Nivelit të Dyte”

Çdo program studimi MND duhet te kete objektiva te caktuara per formimin e studenteve ne ate program, te cilat perbehen nga bashkësia e dijeve, aftësimeve e kompetencave profesionale qe studentet duhet te fitojne ne perfundim te programit te studimit dhe qe karakterizojne profilin kulturor dhe profesional te programit.

Objektivat per formimin e studenteve ne nje program studimi, duhet te ndahen ne:

- a) Objektiva percaktues te programit te studimit, te cilat jane te njejta per programe studimi te njejta apo te ngjashme, te ofruara nga UPT. Keto percaktojne pergatitjen, njohurite, kompetencat dhe mundesite per punesim dhe jane te njejta, pavaresisht emertimit te programit.
- b) Objektiva specifike, te cilet diferencojne programet e njejta ose te ngjashme nga njeri tjetri. Keto objektiva duhet te percaktohen nga UPT.

Per çdo program te caktuar studimi, objektivat formues percaktues te programit dhe veprimtarite formuese (te dhena me poshte) te domosdoshme per t’u ndjekur, duhet te grupohen si me poshte:

- a) veprimtari formuese ne nje ose me shume grupe disiplinash qe lidhen me formimin e pergjithshem (baze) per programin e studimit;
- b) veprimtari formuese ne nje ose me shume grupe disiplinash qe karakterizojne perkatesine e programit te studimit.

SSH.04.05.05 Standardi i veprimtarive formuese te programeve te studimeve “Master i Nivelit të Dytë”

Veprimtarite formuese qe karakterizojne nje program studimi duhet te ndahen ne:

- a) mesim ne auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore);
- b) studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, pergatitje provimesh, pergatitja e tezesh se diplomes, etj.);
- c) veprimtari te tjera, si praktika profesionale apo stazh prane subjekteve publike apo private.

Pervec veprimtarive formuese te mesiperme, programet e studimit duhet te parashikojne, gjithashtu:

- a) veprimtari formuese te zgjedhura nga vete studentet, ndermjet atyre te ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, te realizuar keto gjate viteve akademike te programit te studimit;
- b) veprimtari formuese ne nje ose me shume disiplinash te ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese, qe lidhen kryesisht me formime nderdisiplinore, njohuri ekonomike, juridike, etj.;
- c) veprimtari formuese te paparashikuara me siper dhe te fokusuar drejt perfthimit te aftesive ne gjuhe te huaj, aftesive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese, ose pergjithsisht te aftesive qe lehtesojne hyrjen ne tregun e punes, sikurse aktivitete formuese qe lidhen me praktikat profesionale prane kompanive te ndryshme, administrates publike, enteve private apo publike, urdherave apo kolegeve profesionale, bazuar ne marreveshje te perbashketa per kete qellim.
- d) veprimtari formuese qe lidhen me pergatitjen e tezesh se diplomes.

Ndarja e oreve mesimore ne auditor ne ore per leksione, seminare, ushtrime e laboratore per çdo disipline percaktohet nga personeli akademik pergjegjes per disipinen, ne baze te krediteve qe asaj disipline i jane besuar.

Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 “Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte”, jepen rekomandime per shperndarjen e krediteve sipas veprimtarive te ndryshme formuese, si dhe ndarja e oreve mesimore per nje kredit ne ore ne auditor dhe ore per studim individual.

Studenteve, ne perfundim te programit te studimit, ju njehesohet nota mesatare e ponderuar, qe merr ne konsiderate edhe kreditet respektive per çdo disipline apo veprimtari tjetër formuese.

Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 “Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte”, jepet nje shembull i njehesimit te notes mesatare te ponderuar.

SSH.04.05.06 Standardi i organizimit, kryerjes dhe vleresimit te programit te studimit “Master i Nivelit të Dytë”

Programet e studimit MND duhet te realizohen nepermjet aktiviteteve te ndryshme formuese ne auditor, trainimit, praktikes apo stazhit, ne perputhje me objektivat e programit si dhe studimit e pergatitjes individuale te studenteve. Numri minimal i krediteve per keto programe studimi nuk mund te jete me i vogel se 60 kredite apo 1500 ore pune te studentit, te shperndara ne jo me pak se nje vit akademik.

Programet e studimit MND mund te zhvillohen dhe me kohe te pjeshme dhe ne kete rast ato duhet te shtrihen ne dy vite akademike.

Frekuentimi nga studentete i aktiviteteve te ndryshme formues duhet te jete i detyrueshem. Ne çdo rast, per marrjen e titullit te studimit, frekuentimi duhet te jete te pakten ne masen 80% te aktiviteteve mesimore ne auditor.

Ne perfundim te programeve te studimit MND duhet te parashikohet realizimi i nje prove finale (mikroteze, testim) qe te vertetoje fitimin e kompetencave profesionale apo njohurive te parashikuara.

Organizimi dhe drejtimi i programeve te studimit MND, si dhe aktiviteti mesimor i zhvilluar nga personeli akademik ne keto programe, duhet te vleresohen me ore mesimore.

Asnje nga programet e studimit MND nuk mund te ekuivalentohen me ndonje diplome te nivelit te dyte.

Rezultatet dhe niveli cilesor i aktiviteteve formuese te zhvilluara ne programet e studimit MND vleresohen çdo vit ne perfundim te tij, sipas modaliteteve te percaktuara nga njesia e sigurimit te brendshem te cilesise. Ky vleresim sherben si baze per vazhdimesine e programit te studimit ne vitin e ardhshem.

SSH.04.05.07 Standardi i dokumentacionit per hapjen e programit te studimit “Master i Nivelit të DYTE”

Propozimet per hapjen, mbylljen apo riorganizimine programeve te studimit MND mund te behen nga nje apo me shume njesi kryesore, njesi baze apo dhe anetare te personelit akademik, kur disponohen burime te pershtatshme njerezore dhe te infrastruktures. Keto propozime duhet te shqyrtohen per plotesimin e standardeve akademike ne keshillin e njesise kryesore perkatese dhe ne senatin akademik te UPT.

UPT kerkesen per hapjen dhe riorganizimin e programeve te studimit MND duhet t’a shoqeroje me dokumentacionin e meposhtem:

- a) objektivat e programit, kompetencat profesionale qe synohet te arrihen ne perfundim te tij dhe ndihmesen per qellim punesimi;
- b) kriteret e pranimit te studenteve;
- c) procedurat e pranimit te studenteve dhe te njohjes se krediteve universitare te fituara me pare prej tyre;
- d) kohezgjatja e programit dhe struktura qe e ofron;
- e) numri minimal dhe maksimal i pjesemarrësve ne program;
- f) frekuenca ne aktivitetet e ndryshme formuese (leksione, seminare, laboratore, praktika, etj.);
- g) plani mesimor i programit, i detajuar ne te gjitha aktivitetet formuese, shoqeruar me kreditet perkatese;
- h) personeli akademik qe duhet te angazhohet per realizimin e programit te studimit, shoqeruar me te dhenat e nevojshme;
- i) komiteti shkencor dhe koordinatori i programit;
- j) struktura akademike pergjegjese per menaxhimin administrativ dhe financiar te programit si dhe te karrieres se studenteve;
- k) tarifa per çdo student dhe menyra dhe afatet e pageses se saj; programet e studimit MND vetefinancohen me tarifat e shkollimit te studenteve te regjistruar ne keto programe; sidoqofte, ato mund te shfrytezojne dhe financime nga subjekte bashkepunuese per programin, si dhe burime te siguruara nga njesia/njesite kryesore propozuese apo nga UPT.
- l) rregullorja e programit te studimit;
- m) modeli i diplomes dhe suplimenti i diplomes MND.

Kerkesa dhe dokumentacioni i nevojshem per hapjen apo riorganizimin e programeve te studimit MND duhet te shoqerohet me nje permbledhje te paraqitur sipas modelit te dhene ne shtojcat e Udhezimit Nr.4, dt 22.01.2008 “Per hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve te studimit Master te Nivelit te Pare dhe te Dyte”.

SSH.04.05.08 Standardi i elementeve te planit mesimor te programeve te studimit “Master i Nivelit të Dyte”

Ne planin mesimor te çdo programi studimi, duhet te percaktohen:

- e) emertimi dhe objektivat formuese te programit te studimit;
- f) kuadri i pergjithshem i veprimtarive formuese qe duhen te perfshihen ne kurrikula;
- g) kreditet per çdo veprimtari formuese.

Per percaktimet e mesiperme, UPT duhet te konsultohet paraprakisht me perfaqesues te bizneseve, sherbimeve apo profesioneve respektive, duke j’u referuar gjithashtu edhe nevojave e kerkesave te tregut. Kerkesat e UPT per hapjen dhe mbylljen e programeve te studimit MND duhet te paraqiten ne MASH brenda dates 15 mars te çdo viti. Hapja dhe mbyllja e programeve te studimit MND duhet te behet sipas percaktimeve te dhena ne standardin e pergjithshem te programeve te studimeve.

SSH.04.06 STANDARDET E PROGRAMEVE TE STUDIMEVE TE DOKTORATES

SSH.04.06.01 Standardi i udhezimeve te pergjithshme mbi programet e studimeve te doktorates

Programet e studimeve të doktoratës duhet të jene programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, duhet të kene në bazë të perpunimit të tezes së doktorates kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarura, dhe rezultatet dhe mbrojtja e suksesshme e të ciles duhet të çojne në fitimin e titullit “DOKTOR”.

Ato duhet të organizohen si rregull brenda një projekti të madh kërkimor-didaktik e kulturor dhe duhet të realizohen në koordinim me zhvillimin e dokumentuar të aktiviteteve të kërkimit të njesise apo UPT.

Programet e studimit të doktorates mund të jene edhe nderdisiplinore ose të perbashketa..

Objektivat formues të programeve të studimit të doktorates duhet të jene të gjera, të motivuara dhe të lidhura me motivimet shkencore në fushen e zgjedhur apo në fushat e zgjedhura në rastin e doktoratave dy ose me shume disiplinore.

Programet e studimit të doktorates duhet të permbajne aktivitete didaktike të formimit të thelluar teorik, përvetesimit të metodologjive të kërkimit dhe të teknikave operative specifike, të realizuara këto nepermjet moduleve mesimore, seminareve me kualifikim të larte, stazhit apo praktikave prane strukturave të kualifikuara, etj. Aktivitetet e mesiperme duhet të jene percaktuar qarte, të lidhura me objektivat formues (të dhena me poshte) të programit të studimit të doktorates dhe konkretisht të verifikueshme.

Në përfundim të këtij cikli të tretë duhet të lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr).

SSH.04.06.02 Standardi i objektivave te programeve te studimeve te doktorates

Çdo program studimi të doktoratës duhet të kete objektiva të caktuara për formimin e studenteve në atë program, të cilat përbehen nga bashkësia e dijeve, aftësimeve e kompetencave profesionale që studentet duhet të fitojne në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojne profilin kulturor, profesional dhe shkencor të programit.

Objektivat për formimin e studenteve në një program studimi, duhet të ndahen në:

- a) Objektiva percaktues të programit të studimit, të cilat janë të njëjta për programe studimi të njëjta apo të ngjashme, të ofruara nga UPT. Këto percaktojnë përgatitjen, njohuritë, kompetencat dhe mundësitë për punësim dhe janë të njëjta, pavarësisht emërimit të programit.
- b) Objektiva specifike, të cilat diferencojne programet e njëjta ose të ngjashme nga njëri tjetri. Këto objektiva duhet të percaktohen nga UPT.

Për çdo program të caktuar studimi, objektivat formues percaktues të programit dhe veprimtaritë formuese (të dhena me poshte) të domosdoshme për t’u ndjekur, duhet të grupohen si me poshte:

- a) veprimtari formuese në një ose me shume grupe disiplinash që lidhen me formimin e pergjithshem (baze) për programin e studimit;
- b) veprimtari formuese në një ose me shume grupe disiplinash që karakterizojne perkatesine e programit të studimit.

SSH.04.06.03 Standardi i veprimtarive formuese te programeve te studimeve te doktorates

Veprimtaritë formuese që karakterizojne një program studimi të doktoratës duhet të ndahen në:

- a) mesim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore);
- b) studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitja e tezes së diplomës, etj.);
- c) veprimtari të tjera, si praktika kërkimore prane subjekteve publike apo private.

Perveç veprimtarive formuese të mesiperme, programet e studimit duhet të parashikojne, gjithashtu:

- a) veprimtari formuese të zgjedhura nga vete studentet, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, të realizuar këto gjatë viteve akademike të programit të

studimit;

- b) veprimtari formuese ne nje ose me shume disiplinash te ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese, qe lidhen kryesisht me formime nderdisiplinore, njohuri ekonomike, juridike, etj.;
- c) veprimtari formuese te paparashikuara me siper dhe te fokusuara drejt perftimit te aftesive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese;
- d) veprimtari formuese qe lidhen me pergatitjen e tezës se diplomës.

Ndarja e oreve mesimore ne auditor ne ore per leksione, seminare, ushtrime e laboratore per çdo disipline percaktohet nga personeli akademik pergjegjes per disiplinen, ne baze te krediteve qe asaj disipline i jane besuar.

Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 "Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte", jepen rekomandime per shperndarjen e krediteve sipas veprimtarive te ndyshme formuese, si dhe ndarja e oreve mesimore per nje kredit ne ore ne auditor dhe ore per studim individual.

Studenteve, ne perfundim te programit te studimit, ju njehesohet nota mesatare e ponderuar, qe merr ne konsiderate edhe kreditet respektive per çdo disipline apo veprimtari tjetër formuese.

Ne shtojcen 1, bashkelidhur Udhezimit Nr. 15, dt. 4.04.2008 "Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte", jepet nje shembull i njehesimit te notes mesatare te ponderuar.

SSH.04.06.04 Standardi i kerkesave per hapjen dhe organizimin e studimeve te doktorates

Nisma per hapjen, organizimin apo riorganizimin e programeve te studimit te doktorates mund te ndermerret nga njesite baze ose grupet mesimore-kerkimore te UPT. Propozimi duhet te miratohet nga keshilli i profesoreve te njesise kryesore perkatese dhe senati akademik i UPT. Ky keshill i profesoreve duhet te mbaje pergjegjesine per organizimin dhe drejtimin e programeve te studimit te doktorates.

Nje njesi e UPT duhet te plotesoje keto kerkesa akademike, te infrastruktures dhe financiare per te hapur ciklin e trete te studimeve dhe per te organizuar studime te doktorates:

- a) prani te personelit akademik me titull "PROFESOR", "PROFESOR I ASOCIUAR" ose me graden shkencore "DOKTOR", fituar ne universitetet perendimore dhe me se paku dy vjet eksperience mesimore-kerkimore pasdoktorale;
- b) numer te nevojshem te personelit akademik per te kryer udheheqien e çdo studenti te doktorates ne aktivitetet e kerkimit dhe detyrat respektive didaktike; udheheqesi shkencor i studentit ne nje program studimi doktorate duhet te kete, se paku, graden shkencore "DOKTOR", te fituar ne universitete perendimore.
- c) strukture specifike operative dhe kerkimore per aktivitetet e parashikuara ne programin e studimit (laboratore, biblioteka, studime, etj.);
- d) burime financiare mbeshtetese;
- e) bashkepunim me universitetet e huaja apo subjekte publike dhe private te kerkimit qe garantojne programe te shkembimit te personelit akademik dhe studenteve te doktorates;
- f) modalitetet e verifikimit te veprimtarise kerkimore apo krijuese te studenteve te doktorates, veçanrisht lidhur me pergatitjen e tezës se doktorates.

Kerkesat e UPT per hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve te studimeve te doktorates duhet te paraqiten ne MASH brenda dates 31 janar te çdo viti.

SSH.04.06.05 Standardi i kerkesave mbi organizimin e studimeve te doktorates ne bashkepunim me universitetet e tjera

UPT mund te organizoje programe te perbashketa te studimit te doktorates me nje ose me shume universitete te tjera, ne baze te nje marreveshje midis tyre, duke patur parasysh si me poshte:

- a) programin e studimit te doktorates dhe pergatitjen e tezës se saj qe duhet te kryhen me periudha te alternuara ne secilin prej universiteteve pjesemarrese;
- b) caktimin e dy udheheqesve, nje per secilin universitet per studentet qe zhvillojne programe te tilla; vleresimi pozitiv i te dy udheheqesve eshte kusht per te kaluar ne mbrojtjen e tezës se doktorates;
- c) caktimin e gjuhes ne te cilen do te hartohet dhe paraqitet teza e doktorates apo pjese te saj, percaktuar

- ne marrevshjen midis universiteteve;
- d) anetaret e jurise per mbrojtjen e tezes qe caktohen me vendim te autoriteteve drejtuese te secilit universitet ne numer te barabarte;
 - e) secili universitet i jep studentit qe perfundon me sukses nje program te tille studimi, titullin "DOKTOR" ose ekuivalent me te, duke shenuar ne diplomat perkatese "Teze doktorate ne bashkepunim me universitetin ...".

SSH.04.06.06 Standardi i dokumentacionit per hapjen e programit te studimit te doktorates

Per te hapur nje program studimi te doktorates, njesia e UPT duhet te paraqese prane MASH kerkesen shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- a) fushen shkencore dhe emertimin e programit te studimit te doktorates, referuar nje sektori, disiplinor ose nderdisiplinor, me relacionin shpjegues perkates;
- b) programin e studimit, te miratuar nga senati akademik i UPT, i cili duhet te paraqitet sipas rregullave te parashikuara ne statut dhe te permbaje dhe organizimin, didaktik dhe shkencor, te programit, planin mesimor per fazen e thellimit teorik, si dhe parashikime per periudha te qendrimit ne institucione te huaja kerkimore;
- c) afatet kohore te realizimit te programit te studimit;
- d) tarifen e studimit per çdo student, e argumentuar, si dhe burime te tjera financimi per studimet e doktorates, ne se ka te tille;
- e) parashikimin per numrin maksimal te studenteve, qe mund te regjistrohen çdo vit ne programet e doktorates (jo me i vogel se tre);
- f) personelin akademik, qe do te mbuloje realizimin e disiplinave teorike te studimeve te doktorates si dhe udheheqjen e disertanteve, sipas titullit apo grades shkencore, dhe numrit perkates te studenteve, per çdo udheheqes; ne se ne ekipet mesimore mund te perfshihet dhe personel akademik i ftuar, ai duhet te jete i miratuar nga keshilli i profesoreve te fakultetit;
- g) rregulloren per studimet e doktorates;
- h) te dhenat per strukturen organizative dhe drejtimin e programeve te studimit, njesine baze qe drejton administrativisht programin e doktorates, kur kjo eshte nderdisiplinore, etj.;
- i) dokumentin per pervojat e meparshme te strukturave ne formime pasuniversitare, ne se ka pasur;
- j) bashkepunimet shkencore per realizimin e gjithe programit te studimit, apo pjese te tij me institucione te tjera kerkimore, ose ente, publike apo private;
- k) njesine, apo njesite baze propozuese te programit te studimit te doktorates, qe garantojne ekzistencen e infrastruktures se nevojshme, ndertimore e laboratorike, per zhvillimin e programit;
- l) modelin e diplomes.

Kerkesa per hapjen ose riorganizimin e doktorates duhet te shoqerohet me dokumentacionin si me siper dhe me nje skede permbledhese te pergatitur sipas modelit te shtojces 1 te Udhezimit Nr.5, dt. 22.01.2008 "Per percaktimin e standardeve akademike te nevojshme per hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve te studimit te doktorates, si dhe te elementeve baze sipas te cileve institucionet e arsimit te larte duhet te pergatisin rregulloret perkatese", si dhe Udhezimit Nr.20, dt. 29.07.2009 "Per disa ndryshime ne shtojcen 1 te Udhezimit Nr.5, dt. 22.01.2008. "Per percaktimin e standardeve akademike te nevojshme per hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve te studimit te doktorates, si dhe te elementeve baze, sipas te cileve institucionet e arsimit te larte duhet te pergatisin rregulloret perkatese"

SSH.04.06.07 Standardi i elementeve te programeve mesimore te studimit te doktorates

Programet e studimeve të doktoratës duhet të ndërtohen si programe individuale për aftësim në kërkim shkencor të pavarur. Në to duhet të përcaktohen, veç të tjerave, fusha e studimit, përmbajtja dhe veprimtaria kërkimore.

SSH.04.06.08 Standardi i elementeve te planit mesimor te programeve te studimit te doktorates

Ne planin mesimor te çdo programi studimi, duhet te percaktohen:

- a) emertimi dhe objektivat formuese te programit te studimit;
- b) kuadri i pergjithshem i veprimtarive formuese qe duhen te perfshihen ne kurrikula;
- c) kreditet per çdo veprimtari formuese.

Per percaktimet e mesiperme, UPT duhet te konsultohet paraprakisht me perfaqesues te institucioneve shkencore, duke j'u referuar gjithashtu edhe nevojave e kerkesave te tregut.

SSH.04.06.09 Standardi i pranimit dhe regjistrimit te kandidatave ne programet e studimit te doktorates

Pranimi i kandidatave ne programet e studimit te doktorates duhet te behet duke iu referuar numrit te kuotave te dhena per programin perkates.

Me caktimin e kuotave nga Keshilli i Ministrave per nje program studimi doktorate, UPT duhet te shpalle menjehere hapjen e procedures se pranimit te kerkesave per nje periudhe 2 javore pasi merr paraprakisht mendimin e njesise kryesore pergjegjese per organizimin e ketij programi studimi.

Aplikimi per regjistrim ne programet e doktorates duhet te behet prane sekretarive te njesive kryesore pergjegjese per organizimin e programit perkates te doktorates.

Duhet te kene të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar ne nje program studimi te doktorates ata studente qe zoterojne diplome te nivelit të dytë, diplome te integruar te nivelit te dyte, diplome tjeter studimi te fituar brenda apo jashte vendit, ekuivalente me to, ne fushen e programit te doktorates apo ne nje fushe te perafert te percaktuar me pare ne Rregulloren e programit perkates te doktorates. Gjithashtu kane te drejte te pranohen ne programe te doktorates edhe ata candidate qe zoterojne nje diplome apo çertifikate te kualifikimit te ciklit te trete te studimeve.

Njesite kryesore te UPT, pasi marrin paraprakisht mendimin e keshillit te profesoreve duhet te percaktojne kriteret specifiket te pranimit ne programet e doktorates, bazuar dhe ne rekomandimet e Keshillit te Arsimit te Larte dhe Shkences. Keto kriteret duhet te percaktohen ne statutin e UPT dhe duhet te behen publike para fillimit te pranimeve te radhes ne UPT.

Njesite kryesore te UPT, qe jane pergjegjese per organizimin e programit te studimit te doktorates, duhet te organizojne edhe procesin e pranimit dhe regjistrimit te kandidatave ne çdo program perkates studimi doktorate. Procesi duhet te monitorohet nga Rektorati i UPT dhe MASH.

Kuotat e pranimit në UPT, për programet e studimeve të doktorates, duhet te miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të MASH. MASH duhet te formuloje propozimin e saj pas konsultimit me UPT, duke marre parasysh dhe rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

SSH.04.06.10 Standardi i dokumenteve te regjistrimit te kandidatave ne programet e studimit te doktorates

Kandidatet duhet te aplikojne per t'u regjistruar ne nje program studimi doktorate me dosje individuale, e cila duhet te permbaje dokumentet e meposhtme:

- a) Kerkesa e kandidatit drejtuar keshillit te profesoreve te njesise kryesore pergjegjese per organizimin dhe administrimin e doktorates.
- b) CV personale dhe bibliografi te punimeve shkencore, te cilat duhet te jene te dokumentuara, ne se kandidati ka te tilla.
- c) Kopje te noterizuar te diplomes se nivelit te dyte (DND), apo te diplomes se integruar te nivelit te dyte, apo te nje diplome tjeter studimi, ekuivalente me to te shoqeruar me listen e notave apo suplementin e diplomes. Diploma e huaj duhet te shoqerohet me vertetimin e njohjes nga MASH.
- d) Kopje te noterizuar te diplomave apo çertifikatave te kualifikimeve te ciklit te trete apo te nje diplome ose çertifikate ekuivalente me to shoqeruar me listen e notave apo suplementin e diplomes ne se kandidati disponon nje te tille.
- e) Fotokopje te noterizuar te kartes se identitetit/pasaportes.
- f) Dy fotografi.
- g) Dy rekomandime nga persona me titull akademik.
- h) Nje deklarate qe pranon te shlyeje te gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e ketyre

studimeve, sipas percaktimeve te bera nga UPT.

- i) Deshmi te gjuhes/gjuheve te huaja (fotokopje te noterizuara).
- j) Vertetimnga qendra e punes ne se eshte i punesuar.
- k) Mandat per tarifen e aplikimit per konkurim prej 2000 leke.

SSH.04.06.11 Standardi i perzgjedhjes dhe regjistrimit te studenteve ne programin e studimit te doktorates

Perzgjedhja e kandidateve duhet te behet nga keshilli i profesoreve i njesise kryesore te UPT pergjegjese per organizimin e programit perkates te doktorates nepermjet nje konkurimi me dosje, ku kandidatet nga personeli akademik te punesuar me kohe te plote ne UPT duhet te kene perparesi.

Keshilli i profesoreve te njesise kryesore pergjegjese per programin e doktorates duhet te ngreje komisione ad-hoc me anetare te tij sipas fushes perkatese te çdo programi doktrate per perzgjedhjen e kandidateve fitues ne perputhje me kriteret e pranimit te vendosura dhe shpallur publikisht me pare. Kryetar i çdo komisioni te tille duhet te jete dekani.

Nje jave pas mbylljes se aplikimeve komisionet ad-hoc duhet te paraqesin listat e kandidateve fitues ne keshillin e profesoreve te njesise kryesore. Listat e kandidateve fitues duhet te miratohen nga keshilli i profesoreve dhe duhet te shpallen nga dekani jo me vone se 2 jave nga mbyllja e aplikimeve.

Dekani i njesise kryesore duhet te percaktoje afatet e ankimit te kandidateve te shpallur jo fitues. Keshilli i profesoreve duhet te shqyrtoje çdo ankimim dhe te shprehe vendimin. Vendimi i tij duhet te jete perfundimtar.

Kandidatet fitues duhet te regjistrohen ne sekretarine e njesise kryesore pergjegjese per programin perkates te doktorates per nje periudhe njejavore te percaktuar nga dekani i njesise kryesore.

Kandidatet fitues duhet te paguajne nje tarife 5 000 leke per regjistrimin ne programin e studimit te doktorates ku jane shpallur fitues. Dosja individuale me dokumentet e aplikanteve jofitues duhet t'u kthehet atyre kundrejt kerkeses ne dore ose me poste.

Studentet e regjistruar te cilet kane perfunduar ose vijojne programin e studimit te ciklit te trete nuk jane te detyruar te grumbullojne 60 kreditet e studimeve te organizuara teorike, pjese e programit te studimit te doktorates, vetem ne se programi i studimit te cilin ata kane perfunduar apo vijojne ka formim teorik te njejte ose te afert me ate te programit te doktorates.

Keshilli i profesoreve duhet te ngreje komisionet e drejtuara nga koordinatori i programit te doktorates per njohjen dhe transferimin e krediteve te fituara nga studentet e regjistruar, te cilet kane perfunduar ose vijojne nje program studimi te ciklit te trete, ne varesi te perputhshmerise se tyre me programin e studimit te doktorates ku ai eshte regjistruar. Per çdo student te tille duhet te percaktohen veprimtarite formuese, modulet lendore dhe kreditet perkatese te cilat ai eshte i detyruar te fitoje nga plani i studimeve te organizuara te programit te studimit perkates te doktorates.

SSH.04.06.12 Standardi i tarifes se shkollimit per nje program studimi doktrate

Tarifa e shkollimit per nje program doktrate duhet te jete e percaktuar me Vendim te Keshillit te Ministrave, ku brenda vleres se percaktuar duhet te paraqese:

- a) vleren per pjesen e studimeve te organizuara e cila ndahet per çdo modul lendor ne varesi te krediteve qe i takojne atij;
- b) vleren per pjesen e studimeve per periudhen qe permbledh kerkimin shkencor dhe pergatitjen e disertacionit deri ne marrjen e diplomes per graden shkencore "DOKTOR".

Tarifa e shkollimit duhet te paguhet nga studenti ne keste te percaktuara nga njesia kryesore e UPT pergjegjese per organizimin e doktorates. Kesti i pare duhet te paguhet menjehere me regjistrimin e studentit dhe eshte sa vlera e tarifes per pjesen e studimeve te organizuara. Studentet qe kane transferuar kredite nga programe te tjera te ciklit te trete duhet te paguajne vleren perkatese sipas moduleve lendore dhe krediteve qe ata duhet te fitojne ne programin perkates te doktorates.

SSH.04.06.13 Standardi i udhezimeve mbi rregulloret e organizimit dhe funksionimit te programeve te studimit te doktorates ne UPT

UPT duhet te percaktoje me rregullore te vecante organizimin dhe funksionimin e programeve te studimit te doktorates, dhe ne te duhet te parashikohen:

- a) modalitetet per hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve te studimit te doktorates;
- b) organet pergjegjese per menaxhimin e programeve te studimit te doktorates;
- c) kriteret e pranimit ne programet e studimit te doktorates te atyre qe zoterojne nje diplome te nivelit te dyte, diplome te integruar te nivelit te dyte, diplome sipas sistemit te vjeter apo titull akademik ekuivalent te fituar jashte vendit dhe te njohur nga organet kompetente, brenda dates 30 shtator te vitit kur shpallet konkursi i pranimit;
- d) modalitetet per perzgjedhjen nga keshilli i profesoreve te njesise kryesore ku zhvillohet programi i studimit te doktorates i kandidateve fitues per ndjekjen e programit, bazuar ne vleresimin e kurrikulumeve personale te tyre, rezultateve te tipit te formimit te meparshem universitar te tyre, ne vleresimin e projektit te kerkimit te propozuar, rekomandimeve dhene nga dy profesore, njohurive te gjuheve te huaja dhe sidomos te gjuhes angleze, etj.;
- e) modalitetet e publikimit ne organet e medias se shkruar dhe ne internet te kriterëve, procedurave dhe afateve per konkurset e pranimit me informacionet e tjera te nevojshme;
- f) te drejtat dhe detyrat e studenteve te doktorates;
- g) numrin e studenteve te udhehequr njekohesisht nga nje udheheqes, sipas propozimit te keshillave te profesoreve te njesive kryesore perkatese;
- h) modalitetet e perfshirjes ne programet e studimit te doktorates te studenteve qe jane ne marredhenie pune, si per shembull, lektore te institucioneve te tjera te arsimit te larte apo te administrates publike, etj., ne perqindje te caktuara, te cilet nuk jane ne gjendje te sigurojne nje frekuentim te plote te aktiviteve te parashikuara per doktoraten; zgjatja e studimeve ne rastet e mesiperme mund te shkoje deri ne gjashte vjet.
- i) tipologjine e aktiviteve formuese didaktike ne programet e studimit te doktorates, sipas percaktimeve te dhena ne "Standardin e udhezimeve te pergjithshme mbi programet e studimeve te doktorates"; programet e studimeve te doktorates duhet te zgjasin të paktën 3 vite dhe te përfshijnë edhe 60 kredite për studime të organizuara.
- j) afatet e prezantimit dhe te diskutimit te tezës se doktorates, qe s' duhet te kapercejne 4 vjet nga regjistrimi ne program, perjashtuar studentet qe jane ne marredhenie pune;
- k) modalitetet per pranimin ne mbrojtjen e tezës se doktorates per marrjen e titullit, te percaktuara nga keshilli perkates i profesoreve, perfshire dhe verifikimin e plotesimit te kushteve sipas standardit te kushteve qe duhet te plotesojne dhe te drejtat e studenteve te programeve testudimit te doktorates
- l) kushtet dhe kufijte e angazhimit te studenteve te doktorates si tutore te studenteve ne programet e studimit te ciklit te pare dhe te dyte dhe ne aktivitetet per mbeshtetjen e udheheqesit te tyre ne mesimdhenie, duke respektuar standardin e personelit akademik me kontrate.
- m) modalitete te sigurimit te mobilitetit te pakten nje tremujor te studenteve te doktorates ne universitete apo institute kerkimore te huaja;
- n) mundesite dhe modalitetet per mbeshtetjen financiare te studenteve te doktorates;
- o) modalitetet e vleresimit vjetor te rezultateve te programit, percaktuar sipas udhezimeve te njesise se brendshme te sigurimit te cilesise;

Kandidatët, që kanë diplomë të nivelit të dytë dhe diplomë "Master i Nivelit të Dytë", nuk janë të detyruar të grumbullojnë 60 kredite të studimeve të organizuara teorike. Këta duhet te paraqesin disertacionin e doktoratës, sapo të kenë plotësuar kushtet e tjera, që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave për studimet e doktoratës.

Rregullores se doktorates duhet t'i bashkelidhen dhe modele te caktuara te dokumenteve per kontratat e ndryshme te bashkepunimit, per vleresimin vjetor te punes se bere nga studentet e doktorates, si dhe te tezës se doktorates, per strukturen e hartimit te tezës se doktorates dhe abstraktit te saj, etj.

SSH.04.06.14 Standardi i kushteve qe duhet te plotesojne dhe i te drejtave te studenteve te programeve te studimit te doktorates

Gjate periudhes se studimeve te doktorates, para paraqitjes ne provimin e doktorates, studenti duhet te kete plotesuar kushtet e meposhtme:

- a) te kete realizuar, se paku, tre referime ose paraqitje (poster) shkencore, nga te cilat nje referim ose paraqitje duhet te jete mbajtur ne nje veprimtari shkencore nderkombetare (simpozium, konference, kongres), i pranuar ne baze te nje vleresimi paraprak shkencor dhe i botuar ne “Procesings”, te indeksuar me kod ISBN-je;
- b) te kete botuar, si autor i pare, se paku tri artikuj shkencore ne revista shkencore. Se paku, njeri prej tyre duhet te jete botuar ose pranuar per botim ne nje reviste shkencore nderkombetare me bord editorial.
- c) te kete pergatitur dhe paraqitur ne keshillin e profesoreve te fakultetit disertacionin, se bashku me nje permbledhje te miratuar nga udheheqesi shkencor; struktura e disertacionit dhe e permbledhjes se tij duhet te percaktohen ne rregulloren e studimeve te doktorates.

Studentet qe jane ne marredhenie pune dhe te perfshire ne aktivitetet e kerkimit prane UPT, pas regjistrimit ne programet e studimit te doktorates, mund te kerkojne te zhvillojne pjese te aktivitetit te tyre te kerkimit prane vendit te punes ose te specializimit, sipas nje plani te percaktuar nga keshilli perkates i profesoreve.

Studentet qe zoterojne tituj shkollimi pas ciklit te dyte te studimeve, per shembull “Master i Nivelit te Dyte”, etj. apo ne kerkim, mund te kerkojne pas pranimit ne programin e studimit te doktorates, te kalojne ne vitin e dyte te saj ose t’u njihen dhe vleresohen titujt e shkollimit qe zoterojne.

SSH.04.07 STANDARDE TE PROGRAMEVE TE TJERE TE STUDIMIT

SSH.04.07.01 Standardi i programeve te studimeve ndërdisiplinore

Brenda UPT, fakultetet mund të organizojnë programe të përbashkëta të studimeve ndërdisiplinore. Programe të tilla mund të organizohen edhe ndërmjet fakulteteve të UPT dhe institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

Në përfundim të programeve të studimeve ndërdisiplinore duhet të lëshohet diplomë e përbashkët nga të dy institucionet e arsimit të lartë, ku duhet të shenohen institucionet bashkepunuese.

SSH.04.07.02 Standardi i programeve te studimeve të përbashkëta

Programet e studimeve të përbashkëta mund të realizohen në një UPT ose njësi kryesore të tij, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose private, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Programet e studimeve të përbashkëta duhet të organizohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Në përfundim të studimeve duhet të lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë, ku duhet të shenohen institucionet bashkepunuese.

SSH.04.07.03 Standardi i programeve te studimeve të formimit të vazhduar

Në vijim të programeve të ndryshme të studimeve, UPT mund të ofrojë programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe duhet të shërbejnë për specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive. Ato mund të jenë dhe programe të kërkimit të avancuar. Programet e studimeve të formimit të vazhduar duhet të ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit të tyre dhe të aftësive profesionale.

Në kuadër të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, UPT mund të organizojë edhe forma të tjera të ndryshme të mësimin informal si kurse, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme.

Programet e studimeve të formimit të vazhduar duhet të përmbajnë elementet e mëposhtme:

- a) të dhëna të përgjithshme për programin, formën dhe objektivat kryesorë, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve;
- b) klasifikimin e programit të studimit, që bëhet i zbatueshëm me krijimin e kuadrit shtetëror të kualifikimeve;
- c) kushtet e pranimeve në programin e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes në rastet e pranimeve me numër të kufizuar;
- ç) metodat e vlerësimit të studentëve dhe kushtet për përparim në program;
- d) kushtet për transferime ndërmjet programeve dhe kushtet për përfundimin e pjesshëm të programit, nëse ai e parashikon këtë gjë;
- dh) titujt profesionalë, që akordohen sipas ligjit, etj.

Struktura e programeve të studimeve të formimit të vazhduar, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre duhet të përcaktohen në mënyrë të pavarur nga UPT.

Per hapjen e programeve të studimit të formimit të vazhduar, UPT duhet t'i dergojë propozimin MASH shoqëruar me dokumentacionin, që duhet të përmbajë: emertimin e programit, strukturën dhe kohezgjatjen e tij, si dhe modelin e çertifikates, që lëshohet në përfundim të programit.

SSH.04.07.04 Standardi i programeve te studimeve jouniversitare dyvjeçare

UPT mund të ofrojë programe studimi jouniversitare dyvjeçare (jo më pak se 120 kredite), të natyres profesionale, në përfundim të cilave duhet të lëshohet diplomat perkatese.

Per t'u pranuar në një program studimi jouniversitar, të natyres profesionale, kandidati duhet të ketë përfunduar me sukses Maturën Shtetërore ose të zotërojë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të, si dhe të plotësojë standardet akademike të kriterëve të pranimit të UPT për këtë program studimi, të cilet behen publike të pakten një vit para fillimit të pranimeve të radhes në institucion. Në përfundim, duhet të jepet diploma perkatese.

SSH.04.07.05 Standardi i programeve te studimit me kohe te pjesshme ose ne distance

Kohezgjatja e nje programi studimi me kohe te pjesshme ose ne distance duhet te jete percaktuar sipas percaktimeve te bera ne udhezimin perkates te MASH per organizimin e studimeve ne kohe te pjesshme dhe ne distance.

SSH.04.07.06 Standardi i ndjekjes se një programi të dytë studimi

Individët që kanë përfunduar një program studimi, duhet te kene të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast, kandidatët duhet te përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

Në statutin e UPT duhet te përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen për t'u pranuar në një program të dytë studimi.